



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3299/ 10 prot

Datë 24.12.2024

V E N D I M
Nr. 1848 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.12.2024 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK mbi shfuqizimin e vendimit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” SHPK dhe “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik IT Gjergji Kompjuter” ShPK, me Nipt K81503063B dhe adresë: Nj. Administrative nr.2, Rr. “Faik Konica”, Nr. 3, hyrja 7, Tiranë.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me Nipt J62426002Q dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK me Nipt. L91418502J dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, Z. kadastrale nr.8517, Nd. 4 kate, Spitallë, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës.
Adresa: Lagjja nr.1, Rruga Tregtare, Durrës.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK me Nipt. L91418502J dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, Z. kadastrale nr.8517, Nd. 4 kate, Spitallë, Durrës.

Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, me Nipt K81503063B dhe adresë: Nj. Administrative nr.2, Rr. “Faik Konica”, Nr. 3, hyrja 7, Tiranë.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me Nipt J62426002Q dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues, për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.10.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar“, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit në datën 21.10.2024, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“InfoSoft Office” SHPK	me ofertë	1,249,970	L pa TVSH	Skualifikuar
“Librari Dyrrahu” SHPK	“	1,280,000	“	Kualifikuar
“Marketing & Distribution” SHPK	“	1,352,550	“	Skualifikuar
“IT Gjergji Kompjuter” SHPK.	“	1,469,997	“	Skualifikuar

II.3. Më datë 04.11.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin paraprak të fituesit, publikuar edhe në buletinin e njoftimeve publike me Nr.78, datë 11 Nëntor 2024.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër aplikimi A/2024/4766, datë 11.11.2024 dhe me nr. 3299/2024 prot., datë 11.11.2024 e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”

me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar, si edhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin e publikimit nr.3299/2 prot., datë 12.11.2024, ku u publikuan pretendime të ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me **nenin 113** të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me shkresën paraqitur on-line, protokolluar me tonën me Nr.3299/3, datë 18.11.2024, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK duke kundërshtuar pretendimet e ankimuesit.

II.7. Autoritet Kontraktor me shkresën nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024, ardhur në sistem, protokolluar me tonën me nr. 3299/4 prot., datë 19.11.2024, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin Nr. 2498 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, si edhe me postë në formë shkresore me nr.2498/2 prot., datë 19.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3299/5 prot., datë 21.11.2024, me objekt “Kthim përgjigje ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke njoftuar vendimin e KSHA-së për pranim të pjesshëm të ankesës.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me numër ankimimi elektronik A/2024/4771, datë 11.11.2024 dhe me Nr. 3317/2024 Prot., datë 12.11.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ankimuesit.

II.9. Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3317/2

prot., datë 12.11.2024, u publikuan pretendime të ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.10. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* me shkresën paraqitur on-line, protokolluar me tonën me Nr.3317/3, datë 18.11.2024, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatorit “InfoSoft Office” ShPK, duke kundërshtuar pretendimet e ngritura.

II.11. Autoritet Kontraktor me shkresën nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024, ardhur në sistem, protokolluar me tonën me nr. 3317/4 prot., datë 19.11.2024, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin Nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, si edhe me postë në formë shkresore me nr. 249812 prot., datë 19.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3317/5 prot., datë 21.11.2024, me objekt “Kthim përgjigje ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke njoftuar vendimin e KSHA-së për pranim të plotë të ankesës.

II.12. Me shkresën nr. 3299/6 prot., datë 25.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon autoritetit kontraktor Informacioni si vijon:

[...] Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me shkresën paraqitur on-line, protokolluar me tonën me Nr.3299/3, datë 18.11.2024, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK duke kundërshtuar pretendimet e ankimuesit.

Si edhe me shkresën paraqitur on-line, protokolluar me tonën me Nr.3317/3, datë 18.11.2024, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatorit “InfoSoft Office” SHPK, duke kundërshtuar pretendimet e ngritura.

Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kërkojmë të na informoni për sa më poshtë:

- 1. A e keni njoftuar operatorin ekonomik të Interesuar “Librari Dyrrahu” SHPK, mbi vendimmarrjet e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” ShPK si edhe të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK.*
- 2. Nëse po, ju lutem të na dërgoni fotokopje të librit të protokollit që vërteton dërgimin e dy vendimeve të KSHA-së operatorit ekonomik të interesuar.*

Nëse jo, Autoriteti kontraktor ka detyrim t’i përcjellë vendimmarrjet e KSHA-së, operatorit ekonomik të interesuar “Librari Dyrrahu” SHPK porsa kohë ka paraqitur pretendime në lidhje me ankesat.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

II.13. Me shkresën nr. 2593/1 prot., datë 03.12.2024, protokolluar me tonën me nr. **3299/7**, datë 05.12.2024 me objekt: “Kthim Përgjigje” autoriteti kontraktor informon:

[...] Në vijimësi të shkresës tuaj nr. 3299/6 prot., datë 25.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 2593, datë 02.12.2024, Ju bëjmë me dije si më poshtë;

- Autoriteti Portual Durrës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor procedoi me dërgimin operatorit ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPK të vendimmarrjeve të KSHA-së përsa i përket ankesave të paraqitura nga operatorët ankimues “*IT Gjergji Kompjuter*” ShPK si edhe “*InfoSoft Office*” ShPK.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni fotokopje të librit të protokollit.

Referuar shkresës dhe kopjes se librit të dorëzimit, rezulton se AK ka përcjellë vendimet për OE. “*Librari Dyrrahu*” ShPK më datë 02.12.2024.

II.14. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/4871, datë 09.12.2024 dhe me Nr. 3580/2024 Prot., date 10.12.2024 e operatorit ekonomik “*Librari Dyrrahu*” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “*Kancelari*”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “*IT Gjergji Kompjuter*” ShPK dhe operatorit ekonomik “*InfoSoft Office*” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.15. Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe Formularin për publikim nr. 3580/2 prot., datë 11.12.2024, mbi pretendimet e ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të sipërcituar si më poshtë vijon:

Pasi u njohëm më datë 03.12.2024, nëpërmjet shërbimit postar, me vendimin nr. 2498/2 datë 19.11.2024 dhe arsyetimin e dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, kundërshtojmë atë në lidhje me vlerësimin e mostrave të dorëzuara nga “*IT Gjergji Kompjuter*” ShPK për artikujt mostra të paraqitura me pretendimet:

- *Mostrat e paraqitura nga ana e OE “IT Gjergji Kompjuter ShPK” për art 5 dhe 8 kalojnë specifikimet, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në dokumentet e tenderit.*

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendime për operatorin ekonomik “*InfoSoft Office*” ShPK si poshtë vijon:

- *Ankesa e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 11.11.2024 ora 16:00:25 me numër elektronik të ankesës A/2024/4771, jashtë afateve ligjore të ankimimit, jashtë Orarit zyrtar të punës së AK, pra jashtë ditës së punës që vjen pas.*

Orari zyrtar i AK-së është 08:00 – 16:00. Ankimi i OE rezulton të jetë bërë jashtë ditës së punës që vjen pas.

- Kundërshtojmë Vendimin nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, në lidhje me vlerësimin e mostrave të dorëzuara nga “InfoSoft Office” ShPK, për art. 5 dhe 8 i kalojnë specifikimet teknike, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në dokumentet e tenderit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave dhe dokumentacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me nr. A/2024/4771, datë 11.11.2024 dhe me Nr. 3317/2024 Prot., datë 12.11.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, mbi skualifikimin e ofertës së tij, nga procedura e prokurimit të sipërcituar në lidhje me arsyet e skualifikimit.

Në kriteret teknike janë kërkuar mostra për produktet me mbi 300 copë.

Në mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik, produkti, me numër rendor 5 është kërkuar me 2 cm i gjerë operatori ekonomik ka sjellë produkt me trashësi 3,3 cm.

Në mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik, produkti me numër rendor 8 është kërkuar me 20 fletë, operatori ka sjellë mostër me 30 fletë.

- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), konstaton se:

1. Në lidhje me arsyen për skualifikim se mostra nr.5 e dorëzuar (dosje kartoni me llastik) ka gjerësi prej 1.3 cm më të madhe nga sa kërkuar, komisioni gjykon që ky ndryshim në gjerësi nuk cenon as funksionalitetin, as qëllimin për të cilin do të përdoret, duke plotësuar kështu kërkesën e AK.

2. Në lidhje me arsyen për skualifikim se mostra nr.8 e dorëzuar (dosje me qese brenda) përmban 10 fletë më shumë se sa kërkuar, komisioni gjykon që ky ndryshim nuk cenon as funksionalitetin, as qëllimin për të cilin do të përdoret, duke plotësuar kështu kërkesën e AK.

PËR KËTO ARSYE: Komisioni, pasi administroi dosjen e prokurimit të sipër përmendur, shqyrtoi dhe analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti ankimues.

Në përfundim të këtij procesi, komisioni i caktuar arriti në konkluzionet, që: Kërkesa e OE ankimues rezulton e mirë argumentuar dhe për rrjedhojë,

KSHA-ja konkludon se pretendimet e shoqërisë “InfoSoft Office” ShPK qëndrojnë.

III.1.1. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, me shkresën paraqitur on-line, protokolluar me tonën me Nr.3317/3, datë 18.11.2024, operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK, ka paraqitur argumente në lidhje me ankesën e operatorit “InfoSoft Office” ShPK, duke kundërshtuar pretendimet e ngritura.

III.1.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/4871, datë 09.12.2024 dhe me Nr. 3580/2024 Prot., date 10.12.2024 e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK si edhe neneve 113 dhe 114 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se: “[...]5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni. 6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.. [...]”,

Komisioni konstaton se operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK ka paraqitur ankesën nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike e cila rezulton brenda afatit ligjor si edhe përmban të gjithë elementët formalë të saj.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, të marrë në shqyrtim ankesën në lidhje me pretendimet e ngritura mbi kundërshtimin e Vendimit të KSHA-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.

III.1.3. Në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, i cili ngre pretendime në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Ankesa e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 11.11.2024 ora 16:00:25 me numër elektronik të ankesës A/2024/4771, jashtë afateve ligjore të ankimimit, jashtë Orarit zyrtar të punës së AK, pra jashtë ditës së punës që vjen pas.

Orari zyrtar i AK është 08:00 – 16:00. Ankimi i OE rezulton të jetë bërë jashtë ditës së punës që vjen pas.

- Kundërshtojmë Vendimin nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, në lidhje me vlerësimin e

mostrave të dorëzuara nga “InfoSoft Office” SHPK, për art. 5 dhe 8 i kalojnë specifikimet teknike, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në dokumentet e tenderit.

III.1.4. Lidhur me pretendimin e parë të ankesës së operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- *Ankesa e operatorit ekonomik ankimes “InfoSoft Office” ShPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 11.11.2024 ora 16:00:25 me numër elektronik të ankesës A/2024/4771, jashtë afateve ligjore të ankimit, jashtë Orarit zyrtar të punës së AK, pra jashtë ditës së punës që vjen pas.*

Orari zyrtar i AK është 08:00 – 16:00.

Ankimi i OE rezulton të jetë bërë jashtë ditës së punës që vjen pas.

Komisioni vëren, se referuar materialeve të dosjes administrative në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “InfoSoft Office” ShPK, me nr. ankimi A/2024/4771, datë 11.11.2024 dhe me Nr. 3317/2024 Prot., datë 12.11.2024, për procedurën e prokurimit të sipërcituar, konstaton se më datë 04.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi në SPE për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Referuar bazës ligjore, në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/të klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve **nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. **Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.**

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.** Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është **publikuar njoftimi i fituesit paraprak, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, më datë 04.11.2024.**

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të përlllogaritet sipas përcaktimeve për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, **duke e lidhur fillimin e së drejtës së ankimit me ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundimin e saj në ditën e 7-të.** Sipas verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit për këtë procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim-fituesi me datë 04.11.2024 ndërkohë ankesa është dorëzuar më datë 11.11.2024 në

sistemin e ankesave elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor, datë e cila rezulton brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

III.1.5. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me nr. ankimi A/2024/4771, datë 11.11.2024 dhe me Nr. 3317/2024 Prot., datë 12.11.2024, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit.

Si rrjedhojë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, për lidhje me afatet e ankimit të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK nuk qëndrojnë ndaj përbën shkak për mospranimin e pretendimeve të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa referuar pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me ankesën operatorit “Librari Dyrrahu” ShPK, i cili ngre pretendime për operatorin ekonomik “InfoSoft Office” ShPK në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Kundërshtojmë Vendimin nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, në lidhje me vlerësimin e mostrave të dorëzuara nga “InfoSoft Office” ShPK, për art. 5 dhe 8 i kalojnë specifikimet teknike, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në dokumentet e tenderit.

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike për artikujt 5 dhe 8 objekt skualifikimi

Nr.	Emërtimi i produktit
5	Dosje kartoni me llastik 1.2 cm, 2 cm e i gjerë karton i fortë i papërthyeshëm.
8	Dosje me qese brenda (20 fleta) me xhep plastik ballor për format A4 dhe xhep për kartëvizita.

III.2.2. Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, referuar informacionit të AK-së ka dorëzuar mostrat objekt skualifikimi si vijon:

Për art 5-Dosje kartoni me llastik 1.2 cm, 3.3 cm e gjerë dhe

Për art.8-Dosje me qese brenda (30 fleta) me xhep plastik ballor për format A4 dhe xhep për kartëvizita.

Referuar Vendimit nr. 2498/1 prot., datë 19.11.2024 të KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës, Komisioni vëren, se AK ka pranuar ankesën me arsyetimet se [...]diferencat e konstatuara nuk ndikojnë në cilësinë e produkteve dhe funksionalitetin e tyre[...].

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik të interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK në këtë procedurë prokurimi, gjykon se operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqitin ankesa, brenda afateve të përcaktuara, në lidhje me procedurat e prokurimit kur ata konstatojnë parregullsi si në lidhje me dokumentacionin e procedurës së prokurimit edhe në fazën e vlerësimit të ofertave, kur nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor janë dëmtuar ose rrezikohen të dëmtohen. Komisioni gjykon se ligji material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, siguron integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuar, nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Referuar dokumenteve të sipërcituara Komisioni, pasi mori në shqyrtim specifikimet teknike të DST dhe pretendimet e ankimuesit për mostrat e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, gjykon se diferenca e parametrave të mostrave nuk është e lartë dhe nuk ndikon negativisht në cilësinë e tyre dhe as në funksionin e qëllimin për të cilat do të përdoren këta artikuj kancelarie. Me të drejtë operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK argumenton kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit se një diferencë e ulët nuk ndikon në funksionet e artikujve dhe se kanë paraqitur mostra cilësore dhe funksionale.

Gjithashtu referuar informacionit të AK-së, KSHA me Vendimin e marrë, argumenton drejtë në lidhje me gjykimin e tij për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK dhe se parametrat e artikujve mostra nuk ndikojnë në mosfunksionim të tyre.

Komisioni gjykon se pretendimet e ankimuesit “Librari Dyrrahu” ShPK nuk janë të mirëargumentuara se përse artikujt objekt ankimi nuk janë në cilësinë e kërkuar.

Si rezultat i arsyetimit Komisioni gjykon të drejtë Vendimin e KSHA-së, i cili qëndron në fuqi.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, me pretendimet për skualifikim të ofertës së tij mbi arsyet e skualifikimit:

Arsyet e skualifikimit:

Në kriteret teknike janë kërkuar mostra për produktet me mbi 300 copë.

Në mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik, produkti me numër rendor 5 është kërkuar

me 2 cm i gjerë, operatori ekonomik ka sjellë produkt me trashësi 4 cm.
Në mostrat e dorëzuar nga operatori ekonomik, produkti me numër rendor 8 është kërkuar me 20 fletë, operatori ka sjellë mostër me 30 fletë.

- Autoriteti kontraktor me Vendimin nr. 2498/2 prot., datë 19.11.2024, pranon pretendimet e ankimuesit.

KSHA gjykon që ndryshimet në gjerësi të art 5 dhe për mostrën e art 8 dosja e sjellë ka 10 fletë më shumë, specifikimet e mostrave nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe as në qëllimin e artikujve.

KSHA, pranon ankesën në lidhje me arsyet e skualifikimit.

III.3.1. Neni 30 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Neni 115 pika 1 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ të pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.3.2. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK nga KSHA në lidhje me arsyet e skualifikimit në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “Kancelari”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Komisioni do të vijojë më tej me shqyrtimin e pretendimeve të tjera.

III.4. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, me pretendimet për skualifikim të operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, për mospërmbushje të kriteri 2.3.2 të kapacitetit teknik.

2.3.2 *Operatori duhet të paraqesë mostrat për artikujt me sasi mbi 300 (treqind) copë, mos paraqitja e tyre është kusht për skualifikim. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë mallrat me nr. rendor 1,4, 5,6,7,8,12,27,50, dhe 55 në listën e mallrave.*

Ankimuesi pretendon se:

Artikujt mostra me nr. 4, 5, 8,27 dhe 50 të OE “LIBRARI DYRRAHU” ShPK nuk përmbushin specifikimet teknike si vijon:

Nr.	Emërtimi i produktit
4	Dosje me mekanizëm 7 cm plastike. <i>Dosja e dorëzuar nuk i ka këndet e saj metalike, sikurse kërkohet nga AK-ja.</i>
5	Dosje kartoni me llastik 1.2 cm, 2 cm e gjerë karton i fortë i papërthyeshëm. <i>Dosja nuk e ka llastikun 1.2 cm, nuk është me gjerësi 2 cm + - 2%, nuk është me karton të fortë e të papërthyeshëm, sikurse kërkohet nga AK-ja.</i>
8	Dosje me qese brenda (20 fleta) me xhep plastik ballor për format A4 dhe xhep për kartëvizita. <i>Mostra e dorëzuar nga ofertuesi Librari Dyrrahu SHPK nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara në DT, pasi dosja e dorëzuar si mostër për këtë artikull, nuk është dosje me qese brenda me 20 fleta, nuk ka xhep plastik ballor për format A4 si dhe xhepin për kartëvizitat, pra nuk plotëson kërkesat e AK-s.</i>
27	Stilolapsa me maje tip rapid 0.3 - 0.4 mm. <i>Stilolapsi i dorëzuar nuk i ka këto përmasa të majës.</i>
50	Varëse për dokument identifikimi me mekanizëm me kordon të zgjatshëm. <i>Mostra e dorëzuar, materiali i varëses nuk është plastikë në vendin ku do të vendoset dokumenti i identifikimit, nuk është me mekanizëm me kordon të zgjatshim.</i>

- Autoriteti kontraktor me vendimin e KSHA-së nuk pranon pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për operatorin “Librari Dyrrahu” ShPK.

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim ankesën, dokumentacionin e autoritetit kontraktor vëren, se ankimuesi “IT Gjergji Kompjuter ShPK” nuk ka paraqitur pretendime për operatorin ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK i renditur i pari për nga vlera e ofertë.

Gjithashtu ankimuesi “IT Gjergji Kompjuter ShPK” pasi ka marrë dijeni mbi vendimmarrjen e KSHA-së, mbi shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, nuk ka paraqitur argumente për mospranim të pretendimeve tënëgritura në ankesën e tij, mbi skualifikim e “Librari Dyrrahu” ShPK.

Komisioni gjykon, se përsa kohë në renditjen e operatorëve ekonomikë, pas vendimmarrjes së KSHA-së, rezulton se në vend të parë si fitues është operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, edhe nëse hipotetakisht mund të pranoheshin pretendimet e operatorit “IT Gjergji Kompjuter” ShPK nga shqyrtimi i ankesës në KPP, nuk do të fitonte kontratën përsa kohë në renditjen përfundimtare pas Vendimit të KSHA-së, rezulton në vend të fundit të klasifikimit.

Përsa referuar pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

III.5. Në lidhje me ankesën operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK, i cili ngre pretendime në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- *Kundërshtojmë Vendimin nr. 2498/2 prot., datë 19.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, në lidhje me vlerësimin e mostrave të dorëzuara nga “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, për art. 5 dhe 8 i kalojnë specifikimet teknike, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në dokumentet e tenderit.*

III.5.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike për artikujt 5 dhe 8 objekt skualifikimi:

Nr.	Emërtimi i produktit
5	Dosje kartoni me llastik 1.2 cm, 2 cm e gjerë karton i fortë i papërthyeshëm.
8	Dosje me qese brenda (20 fletë) me xhep plastik ballor për format A4 dhe xhep për kartëvizita.

III.5.2. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, referuar informacionit të AK-së, ka dorëzuar mostrat objekt skualifikimi si vijon:

Për art 5-Dosje kartoni me llastik 1.2 cm, 4 cm e gjerë dhe

Për art.8-Dosje me qese brenda (30 fletë) me xhep plastik ballor për format A4 dhe xhep për kartëvizita.

Referuar Vendimit nr. 2498/2 prot., datë 19.11.2024 të KSHA-së, mbi shqyrtimin e ankesës, Komisioni vëren se AK ka pranuar ankesën me arsyetimet se [...]diferencat e konstatuara nuk ndikojnë në qëllimin e produkteve dhe funksionalitetin e tyre[...].

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik referuar ankesës së operatorit ekonomik të interesuar “Librari Dyrrahu” ShPK në këtë procedurë prokurimi, gjykon se operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqitin ankesa, brenda afateve të përcaktuara, në lidhje me procedurat e prokurimit kur ata konstatojnë parregullsi si në lidhje me dokumentacionin e procedurës së prokurimit edhe në fazën e vlerësimit të ofertave, kur nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor janë

dëmtuar ose rrezikohen të dëmtohen. Komisioni gjykon se ligji material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, siguron integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produktet e ofruara janë në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Referuar dokumenteve të sipërcituara Komisioni, pasi mori në shqyrtim specifikimet teknike të DST dhe pretendimet e ankimuesit për mostrat e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK, gjykon se diferenca e parametrave të mostrave nuk është e lartë dhe nuk ndikon negativisht në cilësinë e tyre dhe as në funksionin e qëllimin për të cilat do të përdoren këta artikuj kancelarie. Me të drejtë operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK argumenton kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit se një diferencë e ulët nuk ndikon në funksionet e artikujve dhe se kanë paraqitur mostra cilësore dhe funksionale.

Gjithashtu referuar informacionit të AK-së, KSHA me Vendimin e marrë, argumenton drejt në lidhje me gjykimin e tij për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe se parametrat e artikujve mostra nuk ndikojnë në mosfunksionimin e tyre.

Komisioni gjykon se pretendimet e ankimuesit “Librari Dyrrahu” ShPK nuk janë të mirëargumentuara se përse artikujt objekt ankimi nuk janë në cilësinë e kërkuar.

Si rezultat i arsyetimit, Komisioni gjykon të drejtë Vendimin e KSHA-së i cili qëndron në fuqi.

Përsa referuar pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK mbi shfuqizimin e vendimit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “*Kancelari*”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të mos pranojë ankesën e operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-22824-10-04-2024, me objekt “*Kancelari*”, me fond limit 1,675,807.98 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
4. Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertat duke kualifikuar operatorët ekonomikë “InfoSoft Office” ShPK dhe “IT Gjergji Kompjuter” ShPK sipas Vendimeve të autoritetit kontraktor dhe konstatimeve të këtij vendimi.
5. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

